

LIGJ
Nr.8279, datë 15.1.1998

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7895, DATË 27.1.1995 “PËR KODIN
PENAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të deputetit Fehmi Abdiu,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Shfuqizohet në tërësi ligji nr.8175, datë 23.12.1996 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodin Penal i Republikës së Shqipërisë””.

Neni 2

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë” bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Neni 109 ndryshohet si vijon:

"Rrëmbimi i personit

Rrëmbimi ose mbajtja peng i personit i bërë me qëllim për të fituar pasuri ose për të siguruar çdo lloj përfitimi tjetër, dënohet me burgim nga 10 deri në 20 vjet.

Rrëmbimi ose mbajtja peng i fëmijës nën moshën 14 vjeç, fshehja ose zëvendësimi me një tjetër, dënohet jo me pak se 20 vjet ose me burgim të përjetshëm a me vdekje”.

b) Titulli i nenit 114 ndryshohet në **“Shfrytëzimi i Prostitucionit”**; shfuqizohet paragrafi i tij i dytë dhe shtohet neni 114 a) me këtë përmbajtje:

"Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese

Shfrytëzimi i prostitucionit i kryer:

1. me të mitur;
2. ndaj disa personave;
3. me persona me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie ose duke përfutur nga raportet zyrtare;
4. me mashtrim, shtrëngim, dhunë ose duke përfutur nga paaftësia fizike ose mendore e personit;
5. ndaj një personi që shtyhet ose shtrëngohet për të ushtruar prostitucion jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
6. nga organizata kriminale dënohet nga 7 deri në 15 vjet burgim dhe me konfiskim të mjeteve dhe përfitimeve”.

c) Pas nenit 170, shtohet neni 170 a) me këtë përmbajtje:

"Punësimi i paligjshëm

Punësimi pa regjistrim në organet kompetente ose pa garantuar sigurimin e të punësuarit sipas rregullave, kur është dhënë me parë masë administrative, dënohet me gjobë deri në 10 mijë lekë për çdo rast ose me burgim deri në 1 vit.

Moskryerja me dashje ose mbulimi i shkeljeve lidhur me punësimin dhe sigurimin social nga persona të ngarkuar me zbatimin dhe kontrollin e dispozitave përkatëse, dënohet me gjobë deri në 100 mijë lekë ose me burgim deri në 2 vjet.”

ç) Pas nenit 181, të shtohet neni 181 a) me këtë përmbajtje:

"Moskryerja e detyrave nga organet tatimore

Moskryerja e detyrave që lidhen me vjeljen brenda afatit të caktuar ligjor të taksave dhe tatimeve nga punonjësit e organeve tatimore dhe personat e tjerë zyrtarë që janë ngarkuar me këto

detyra, kur bëhet për fajin e tyre dhe i sjell shtetit dëm në vlerë më të vogël se 1 milion lekë, dënohet me gjobë deri në 2 milionë lekë;

kur vlera është me e lartë se 1 milion lekë dënohet nga 3 deri në 10 vjet burgim”.

d) Në nenin 278 pas fjalëve “minave”, në paragrafët e parë dhe të dytë , shtohen fjalët “lëndë plasëse”.

dh) Pas nenit 283, shtohet neni 283 a) me këtë përmbajtje:

"Trafiku i narkotikëve

Krijimi nga ana e personave, që për shkak të detyrës administrojnë substanca të tilla, i lehtësirave për marrjen a përdorimin e narkotikëve në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore dënohet deri në 10 vjet burgim”.

e) Pas nenit 284 shtohet neni 284 a) me këtë përmbajtje:

"Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale

Organizimi, drejtimi dhe financimi i organizatave kriminale me qëllim kultivimin , prodhimin, fabrikimin ose trafikun e paligjshëm të narkotikëve dënohet me burgim nga 10 deri në 20 vjet.

Krijimi i kushteve apo lehtësirave për veprimtari të tilla nga persona me funksione shtetërore, dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet”.

ë) Pas nenit 284 a), shtohet neni 284 b) me këtë përmbajtje:

"Ndihma në zbulimin e krimeve

Personi i arrestuar ose i dënuar për njërën nga veprat penale që kanë lidhje me trafikun e narkotikëve, armëve, klandestinëve, prostitucionit ose për vepra penale të kryera nga organizata kriminale, që bashkëpunon dhe ndihmon organet e ndjekjes penale në luftën kundër tyre ose, sipas rastit, në zbulimin e personave të tjerë që kryejnë krime të tilla, nuk mund të dënohet më tepër se gjysma e dënimit të parashikuar për veprën e kryer prej tij. Në raste të veçanta, kur konkurojnë edhe rrethana lehtësuese në favor të tij, ky person mund të përjashtohet nga dënimi.”.

f) Në fund të nenit 297 bëhet shtesa me këtë përmbajtje:

“dhe kur kjo organizohet për qëllim fitimi, dënohet me burgim deri në 10 vjet.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.1990, datë 19.1. 1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani